



Tiranë, më 14 Shtator 2007

LETËR E HAPUR

Drejtuar: Zonjës Jozefina Topalli
Kryetare Kuvendit të Shqipërisë

Për dijeni: Z.Sali Berisha
Kryeministër i Shqipërisë

Z. Astrit Patozi
Kryetar i Grupit Parlamentar të PD

Znj. Valentina Leskaj
Kryetare e Grupit Parlamentar të PS

Z. Pëllumb Xhufi
Kryetar i Grupit Parlamentar të LSI

Z. Nikollë Lesi
Kryetar i Grupit Parlamentar Demokristian

Z. Tritan Shehu
Kryetar i Grupit Parlamentar “Demokrat – reformator”

Z. Neritan Ceka
Kryetar i Grupit Parlamentar “Qendra Liberal demokratike”

Z. Vangjel Dule
Kryetar i Grupit Parlamentar “Qendra demokratike”

Z. Skënder Gjinushi
Kryetar i Grupit Parlamentar i Partisë Socialdemokrate

Z. Arian Madhi
Kryetar i Grupit Parlamentar i Partisë Republikane

Z. Lufter Xhuvëli
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Agrare Ambientaliste

Lënda: Kërkesë për shtyrjen e diskutimit në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit për “Për një ndryshim në ligjin për organizatat jofitimprurëse”

E nderuara znj. Topalli,

Së pari na lejoni t’ju falenderojmë për konsultimin e vazhdueshëm dhe përkrahjen që keni dhënë në përfshirjen e shoqërisë civile në diskutimin e iniciativave të rëndësishme, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Sot jemi informuar që Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe Financës ka miratuar projektligjin “Për një ndryshim në ligjin për organizatat jofitimprurëse” dhe diskutimi i këtij projektligji është parashikuar për seancën plenare të ditës së hënë, datë 17 shtator 2007.

Shqetësimet tona kryesore kanë të bëjnë me kufizimin në mënyrë drastike të burimeve të financimit të sektorit, tendencën për të vendosur në kontroll të drejtëpërdrejtë veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse dhe kundërshtitë që krijon ky projektligj me format e organizimit të sektorit jofitimprurës, parashikuar nga ligji në fuqi.

Gjithashtu duam të nënvizojmë që kjo nismë ***nuk është konsultuar me përfaqësuesit e shoqërisë civile*** në Shqipëri. Ne besojmë se për t’i dhënë një frymë sa më demokratike dhe të pranueshme propozimeve për ndryshimin e Ligjit për OJF-të është e rëndësishme që ai të diskutohet me grupet e interesit përpara se të kalojë për miratim në seancë plenare.

Po ashtu do të dëshironim t’ju bënim me dije se që prej një viti një grup organizatash të shoqërisë civile dhe ekspertë të pavarur (juristë, ekonomistë) po punojnë për të paraqitur disa ndryshime në ligjin për OJF-të dhe ligje/akte nënligjore të tjera që ndikojnë mbi veprimtarinë dhe funksionimin e organizatave jofitimprurëse në Shqipëri.¹

Për këtë qëllim, duke patur parasysh rëndësinë e veçantë që paraqet sektori jofitimprurës për zhvillimin e demokracisë në Shqipëri, si dhe predispozicionin e organizatave tona për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për funksionimin e OJF-ve, do të kërkonim që të pezullohej diskutimi i këtij projektligji në seancën plenare të ditës së hënë, datë 17 shtator 2007.

Duke shpresuar në vullnetin tuaj të mirë mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,

¹ Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS) ka inicuar dhe mbështetur këtë iniciativë.

Për organizatat nënshkruese

Altin Hazizaj
Drejtor Ekzekutiv
Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

Brikena Samara
Drejtoreshë Ekzekutive
CANGO Albania, Qendra për bashkëpunim ndërmjet Komuniteteve, Autoriteteve Vendore dhe OJFve

Dritan Shutina
Drejtor Ekzekutiv
Co-Plan, Qendra për Zhvillimin e Habitatit

Juliana Hoxha
Drejtoreshë
Partnerët-Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Vasilika Hysi
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Çapajev Gjokutaj
Drejtor ekzekutiv
Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS)